



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Kom.Dh.Shk.II.nr.970/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtarja Saranda Bogaj-Sheremeti, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Komisioni i Pavarur i Mediave, me seli në Prishtinë, rr. “Perandori Justinian”, nr. 124, kundër debitorit Radio Kosova 2, me seli në Prishtinë, rr. “Nëna Terezë”, p.nr., duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1195/22 të datës 30.05.2023, me datë 22.11.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e kreditorit Komisioni i Pavarur i Mediave, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1195/22 i datës 30.05.2023 **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykatës Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 1195/22 i datës 30.05.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Radio Kosova 2, me seli në Prishtinë dhe e ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.768/21, të datës 03.08.2021, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj, ashtu që e ka përfunduar në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori Komisioni i Pavarur i Mediave, pa i përmendur shkaqet ankimore, me të cilën e ka kontestuar në tërësi aktvendimin e Gjykatës Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1195/22 të datës 30.05.2023, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit, duke e lënë në fuqi Urdhrin për Përmbartim P.nr.768/21 të datës 03.08.2021 si dhe të anulohet aktvendimi

KPPP.nr.1195/22 të datës 30.05.2023 i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë dhe të refuzohet prapësimi i debitorit.

Përgjigje në ankesa nuk ka parashtruar debitori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Komisioni i Pavarur i Mediave, me datën 03.08.2021 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbartimit, kundër debitorit Radio Kosova 2, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës për shumën e borxhit prej 5,600.00 €.

Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komisioni i Pavarur i Mediave, ka caktuar urdhrin P.nr.768/21, të datës 03.08.2021, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës nr.0002817 të datës 19.01.2021, me të cilat i ka urdhëruar debitorin Radio Kosova 2, që të ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës shumën prej 5,600.00 € si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në pajtim me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014, nën kërcënimin të përmbartimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, përmbushja e detyrimit të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit dhe transferimin e tyre në llogarinë e kreditorit, sekuestrimin e letrave me vlerë, sekuestrimi, vlerësimi shënimi i përmbartimit në librin publik të paluajtshmërive, shitjen e sendeve dhe përmbushjen e detyrimit të kreditorit, të bëhet përmbartimi në pjesën e pasurisë së debitorit në shoqërinë tregtare, dorëzimi i sendeve të luajtshme dhe kreditori të fitoj të drejtën e pengun në sendet e luajtshme.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1195/2022 të datës 30.05.2023, me të cilin e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe e ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.768/21,

i datës 03.08.2021, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj ashtu që e ka përfunduar në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se në rastin konkret Faturës nr.0002817 të datës 19.01.2021, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë dokumenti - Faturës nr.0002817 të datës 19.01.2021, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se faturat në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban as nënshkrimin e pranuesit – debitorit dhe nuk ka dëshmi se fatura është pranuar nga debitori. Andaj, duke qenë se debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën e po ashtu fatura nuk përmban as kohën e përmbushjes së detyrimit monetar, si e tillë e njëjta nuk mund të shërbej si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbartueshmërisë. Prandaj, Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktvendimi të atakuar.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar se fatura e lëshuar nga ana e kreditorit nuk përmban nënshkrim nga debitori, e as nuk përcakton kohën e përmbushjes. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga Neni 29 par.3 i LPP, i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shumat dhe koha e*

përmbushjes se detyrimit monetar". Ndërsa nenin 37 të LPP-së përcakton se *"Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit"*.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se dhomat e shkallës së parë kanë konstatuar drejtë se faturat si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përbarimore, respektivisht është lejuar përbarimi nuk i plotëson kushtet në mënyrë kumulative që duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se faturat nuk e përmbajnë nënshkrimin e pranuesit i cili është kusht esencial mbi bazën e së cilës dokumenti i besueshëm fiton tipare të përbarueshmërisë së titullit ekzekutiv, mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimi si i tillë nga debitori. Së këndejmi, Gjykata thekson se pa plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm nuk mund ta ketë fuqinë e titullit përbarues sepse rezulton se debitori nuk e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përbarimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përbarimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve. Nuk është valide pranimin e faturës përderisa ajo nuk është nënshkruar nga përfaqësuesi i debitorit, prandaj një veprim i tillë, për Gjykatën assesi nuk paraqet pranim të faturës.

Së këndejmi, edhe gjykata e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përbarimore organi përbarues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përbarimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Por, organi përbarues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përbarues dhe/apo atij të besueshëm, me ç'rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv, çka nuk nënkupton se nuk mund të anashkalohen prerogativat ligjore të parapara me dispozitat e nenit 29 par.3 të LPP-së.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të

cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbare.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e shkallës së dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.970/23 dt. 22.11.2023

**Gjyqtarja,
Saranda Bogaj-Sheremeti**